



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 17/11

Prishtinë, më 22.06.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa, Xhevdet Neziraj dhe Albana Fetoshi.

Munguan: Naser Osmani dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Avdiu-Zëvendësministër i Financave, Juergen Schatz, Alexander Beetz, Ramadan Islami dhe Teki Shala-GIZ, Isuf Zejna-KDI, Shqipe Arifaj-AKK dhe Lejla Selimi-OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim nga Ministri i Financave lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010 E ftuar: Valdete Daka, Kryetare e KQZ-së;**
- 4. Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ndaj palëve të treta;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi zëvendësimin e pikës 4 me këtë pikë: **Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.**

Rendi i ditës miratohet me ndryshime.

2. Raportim nga Ministri i Financave lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal

Kryetarja, njoftoi se është formuar grupi punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa për monitorimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal në bashkëpunim me GIZ-in. Grupi punues ka përpiluar një listë me pyetje drejtuar Ministrit të Financave, mirëpo meqenëse Ministri ndodhet jashtë vendit, përgjigjet do t'i japë zëvendësministri Ramadan Avdiu. Takimi i parë do jetë me Ministrinë për të parë se deri ku kanë shkuar me implementimin e ligjit, pastaj do të ketë takime edhe me komunat. Në këto takime, përveç grupit punues, mund të marrin pjesë edhe të gjithë anëtarët tjerë të komisionit.

Ramadan Avdiu, lidhur me pasqyrat financiare theksoi që Ministria e Financave e ka nxjerrur një Udhëzim Administrativ për raportim vjetor dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare. Në kuadër të këtij udhëzuesi janë mbajtur trajnime profesionale në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve dhe USAID-in për aftësimin e zyrtarëve financiarë. Ministria e Financave është duke e përgatitur udhëzimin administrativ, i cili do t'i obligojë organizatat buxhetore që t'i përgatisin pasqyrat financiare në baza nëntë mujore. Kryesisht komunat me minoritete nuk i kanë dorëzuar pasqyrat financiare, përderisa komunat tjera me kohë i dorëzojnë këto pasqyra pranë Departamentit për Pushtet Lokal në Ministrinë e Financave. Gjithashtu është duke u realizuar një program në bashkëpunim me USAID-in për vetëvlerësimin e menaxhimit të financave publike nëpër komuna, i cili veç është realizuar në pesë komuna. Faza e dytë e këtij programi përfshin edhe dhjetë komuna tjera dhe deri në fund të vitit 2012 synohet të përfshihen të gjitha komunat. Lidhur me respektimin e pavarësisë financiare, theksoi që të gjitha komunat dhe organizatat buxhetore e kanë pavarësinë e plotë për menaxhimin e granteve dhe mjeteve vetanake. Komunat kanë shfrytëzuar një shkallë të lartë të të hyrave vetanake komunale, pasi që ato mund të mbledhin taksa komunale, të vendosin tarifa për lejet e ndërtimit dhe të vendosin ngarkesa për një shkallë të gjerë të aktiviteteve. Buxhetet komunale janë projektuar dhe aprovuar në bazë të parimeve të reja të sistemit të financimit komunal, duke përfshirë këtu edhe futjen në përdorim të granteve të përgjithshme me sistem të mbyllur dhe grantet specifike me sistem të hapur. Shumat agregate të granteve dhe parametrat e ndarjeve të granteve qeveritare janë aprovuar nga Komisioni i Granteve. Shkalla e të hyrave vetanake për pjesën më të madhe të komunave është duke shënuar rritje progresive, por sipas analizave të Departamentit të Buxhetit Komunal dhe atij të Politikave Fiskale, komunat mund ta shtojnë performancën në vjeljen e të hyrave, sidomos nga tatimi në pronë, mirëpo pritet që deri në vitin 2014 të fillojë të aplikohet edhe tatimi në toka. Lidhur me bashkëpagesat nuk ka probleme, çdo gjë është e monitoruar. Komunat e kanë një grant të përgjithshëm të sistemit të mbyllur që mund të shfrytëzohet për ushtrimin e kompetencave komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Granti i përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë në të hyrat komunale si dhe është mjet adekuat për vendosjen e barazisë ndërmjet komunave. Shuma e grantit të përgjithshëm është 10% e të hyrave totale buxhetore të Qeverisë Qendrore duke përfshirë të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat e jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara dhe të hyrat nga huamarrja. Secila komunë do të pranojë çdo vit një shumë të përgjithshme fikse paushalle në vlerë prej 140.000 € minus 1 € për kokë banori, ndërsa 0 € për komunat me popullsi më të vogël. Indikatorët që janë përdorur për alokimin e grantit të përgjithshëm nëpër komuna janë: popullsia llogaritet me 89%, numri i popullsisë pakicë 3%, komunat

me pakicë kombëtare 2% dhe përmasat gjeografike të komunës 6%. Kriteri për ndarjen e grantit të përgjithshëm i specifikuar i është paraqitur Komisionit të Granteve nga Sekretaria e Komisionit të Granteve, i cili grant është shqyrtuar dhe aprovuar nga anëtarët e komisionit, ashtu siç parashihet me Ligjin e Financave të Pushtetit Lokal. Komisioni i Granteve ka analizuar pikat e dobëta dhe të forta të propozimeve të granteve qeveritare nëpër komuna, të cilat janë përfshirë në raportin e vlerësimeve të përshtatshmërisë së sistemit të financimit komunal për vitet 2010-2011, duke dhënë rekomandimet për përmirësime, të cilat dërgohen në Qeveri për aprovim. Lidhur me menaxhimin janë edhe tri rregullore të nxjerra nga thesari: Rregullorja Financiare e Shpenzimit të Parave Publike, Rregullorja e Të Hyrave dhe Rregullorja për Vonesat në Obligimet e paguara. Deri më tani janë diku rreth 600.000 € vonesa të pa paguara, mirëpo pritet që ato do të likuidohen deri në fund të këtij muaji.

Sali Asllanaj, pyeti se a ka ndonjë çështje lidhur me ligjin që nuk shkon mirë dhe a keni ndonjë ide se çka do të kishte qenë e mundur të përmirësohet në këtë ligj, edhe pse vlerësimet e zëvendësministrit ishin për një funksionim të mirë të ligjit dhe raportim të rregullt të komunave? Ngriti çështjen e grantit stimulues, i cili ka qenë projekt i USAID-it, mirëpo me ligjin aktual është anuluar. Sugjeroi që në të ardhmen të mendohet një variant i tillë, pasi që ky grant ka qenë një mjet stimulues për komunat për të realizuar më tepër të hyra vetanake.

Muhamet Mustafa, kërkoi sqarime rreth vlerësimit të Ministrisë në aspektin e taksave lokale, sa krijon problem ndryshimi i taksave prej komunës në komunë dhe a është ligji duke u zbatuar në tërësi? Kërkoi që në raportin përfundimtar të paraqitet vlerësimi për taksat lokale. Përqindja e mbledhjes së tatimit në pronë ende nuk është e kënaqshme, edhe pse që dhjetë vite është futur ky instrument në përdorim. Shumë të rëndësishme e konsideroi transparencën e procesit buxhetor nëpër komuna, si dhe raportimin për zbatimin e buxhetit të komunës.

Xhevdet Neziraj, sugjeroi që për ndarjen e granteve nëpër komuna, përveç numrit të popullsisë Komisioni i Granteve duhet të ketë parasysh edhe aspektin e zhvillimit ekonomik të komunave, sidomos ato komuna që kanë ngecje buxhetore ose që kanë qenë më tepër të shkatërruara nga lufta. Lidhur me ndarjen buxhetore në bazë të minoriteteve, theksoi që në ato komuna ku jeton dhe vepron komuniteti pakicë, të ndahen më shumë grante dhe të ketë më shumë investime.

Ramadan Avdiu, theksoi që gjatë dëgjimeve buxhetore do të komunikohet me komuna, edhe pse ekziston një diskrepancë në mes të kërkesave dhe mundësive për t'i përmbushur këto kërkesa. Lidhur me grantin stimulues njoftoi që ai grant vazhdon të jepet nga USAID-i, edhe pse nuk përfshihet në ligj. Lidhur me tatimin në pronë theksoi se vërehet një trend i rritjes, sidomos gjatë këtij viti krahasuar me vitin paraprak. Ka pasur raste kur komunat kanë aplikuar taksa komunale paushalle, mirëpo në momentin kur janë hetuar ato menjëherë janë ndërprerë nga organet qendrore. Sa i përket transparencës së procesit buxhetor nëpër komuna, kjo ekziston në raport me Ministrinë, mirëpo nuk dihet se sa janë transparent me publikun. Për aspektin e zhvillimit ekonomik të komunave ekziston ligji, por duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara, sepse vetëm 10% e tërësisë së buxhetit ndahet për grante në komuna, Komisioni i Granteve do të bëjë përpjekje që të bëhet ndarja proporcionale e granteve nëpër komuna. Po ashtu, për komunat me komunitetet pakicë, ligji parasheh ndarje më të madhe të granteve. Në kuadër të Ministrisë, është formuar një komitet për investime kapitale, i cili i shikon të gjitha projektet që vijnë nga organizatat buxhetore që janë në vlerë mbi 1.000.000 € në mënyrë që të vendoset baraspesha e zhvillimit në të gjitha pjesët e Kosovës dhe pastaj të caktohen prioritetet.

Kryetarja, theksoi që gjatë vizitave nëpër komuna që do të bëhen gjatë procesit të monitorimit të ligjit, do të shqyrtohen të gjitha rregulloret që rregullojnë taksën dhe tatimet e brendshme, në mënyrë

që të bëhet krahasimi i ndryshimeve që ekzistojnë nëpër komuna. Nëse vërehet se problemi qëndron te ligji, atëherë komisioni do të bëjë rekomandim për përmirësime.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2010

Kryetarja, theksoi që raporti është shumë i mangët, prej të cilit shihet që buxheti është shfrytëzuar rreth 75% dhe kërkoi detalizime më konkrete për kategoritë e raportit.

Valdete Daka, sqaroi se të dhënat që i kanë anëtarët e komisionit në dispozicion kanë të bëjnë me raportin vjetor të punës, përderisa KQZ-ja e ka përgatitur raportin vjetor financiar të detalizuar, i cili do të dërgohet në Kuvend.

Kryetarja, konsideroi që nuk ka çka të bisedohet me këto të dhëna që i ka komisioni dhe kërkoi nga KQZ-ja të sjellë një raport më të detalizuar, duke paraqitur planin dhe realizimin në përqindje për secilën kategori.

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

P Ë R F U N D I M

Shtyhet raporti për shqyrtim në mbledhjen tjetër të radhës dhe kërkohet nga KQZ-ja të dërgojë një raport të detalizuar financiar.

4. Miratimi i propozim-amendamenteve të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Hykmete Bajrami, theksoi që ky ligj bëhet me qëllim të rritjes së transparencës në raport me ATK-në dhe partnerët potencialë të biznesit. Ndryshimet janë bërë nga grupi punues, por kanë mbetur të diskutohen edhe disa çështje me anëtarët tjerë të komisionit siç është heqja e monopolit të Shoqatës së Kontabilistëve, heqja e obligimit të mbajtjes së trajnimeve nga kjo Shoqatë dhe obligimi i bizneseve individuale dhe ortakërive për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Kryetarja, propozoi në nenin 1 ku përshkruhet qëllimi i ligjit, në rreshtin e tretë të fshihet fjala “raportimin financiar nga ana e shoqërive tregtare”, pasi që përsëritet dy herë kjo fjali.

Kryetarja, propozoi në amendamentin 1, përkufizimi 1.4, fjalia “e miratuar në përputhshmëri me këtë ligj për të kryer punët e auditimit”, të zëvendësohet me “e licencuar të bëjë auditime sipas dispozitave të këtij ligji”.

Kryetarja, propozoi në nenin 1, përkufizimi 1.7, të hiqet fjala “do të thotë”.

Kryetarja, propozoi në amendamentin 1, përkufizimi 1.21.1 fjala “firmë e auditorit” të zëvendësohet me fjalën “firmë e auditimit”.

Hykmete Bajrami, propozoi në amendamentin 1, përkufizimi 1.21.3 fjala “auditorëve ligjor” të zëvendësohet me fjalën “auditorët”.

Komisioni miratoi një zëri **amendamentin 1** më ndryshimet e propozuara.

Komisioni vendosi një zëri që të fshihen **amendamenti 2** dhe **amendamenti 3**.

Hykmete Bajrami, propozoi në nenin 4, paragrafi 2 të ndryshohet si në vijim “ Kriteret për kontabilitet dhe raportim të aplikueshme për mikrondërmarrjet, bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme dhe OJQ-të me status të beneficuar do të rregullohen me një udhëzim administrativ nga KKRF-ja”

Komisioni miratoi një zëri ndryshimin e propozuar në **nenin 4**.

Muhamet Mustafa, propozoi në nenin 6, paragrafi 2.1 fjalja “në formë të dokumenteve ose elektronike” të zëvendësohet me “me dokumente në formë të shtypur ose elektronike”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimin e propozuar në **nenin 6**.

Kryetarja, propozoi në nenin 8, paragrafi 3, të fshihen fjalët në kllapa që janë “bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë dhe shpalosja e shënimeve të pasqyrave financiare”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimin e propozuar në **nenin 8**.

Hykmete Bajrami, propozoi në nenin 9, paragrafi 1.5 “shpalosja e shënimeve të pasqyrave financiare” të zëvendësohet me “dokumentet përcjellëse të pasqyrave financiare”.

Muhamet Mustafa, propozoi në amendamentin 5 të fshihen fjalët në kllapa që janë “pasqyra e pozitës financiare, pasqyra e të ardhurave të përmbledhura dhe cash flow”.

Komisioni miratoi një zëri **amendamentin 5** me ndryshimet e propozuara.

Kryetarja, propozoi në nenin 11, paragrafi 2 fjalja “pasqyrat financiare të konsoliduara që auditohen” të zëvendësohet me “pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të audituara”.

Kryetarja, propozoi në nenin 12, paragrafi 1.4 të fshihet fjala në kllapa “bartësit” dhe fjala “prinitmet e tyre” të zëvendësohet me fjalën “shtypjet e tyre”

Komisioni miratoi një zëri ndryshimet e propozuara.

Komisioni një zëri vendosi që të fshihet paragrafi 1 i **amendamentit 7** dhe të mbetet vetëm titulli i ndryshuar.

Hykmete Bajrami, propozoi në amendamentin 8, titulli “Këshilli kosovar për raportim financiar” të zëvendësohet me “Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar”.

Kryetarja, lidhur me pavarësinë e KKRF-së sqaroi se nëse pavarësohet ky këshill atëherë duhet të rregullohen edhe çështjet tera, sepse mund të ketë implikime buxhetore.

Muhamet Mustafa, theksoi që do të kishte qenë ideale që KKRF-ja të jetë e pavarur, por edhe neni nuk është i keq, vetëm se është nevojshme t’i precizohet Qeverisë dhe Ministrisë respektimi i integritetit profesional të kriteret e përzgjedhjes. Lidhur me anëtarët e KKRF-së, propozoi që të jenë dy anëtarë nga universitetet, dy anëtarë nga OEK-ja dhe dy anëtarë nga shoqatat afariste.

Kryetarja, theksoi që universitetet nuk merren me interesin e bizneseve, ndërsa OEK-ja ekskluzivisht ka të bëjë me bizneset private, ndërsa propozoi që të përjashtohet anëtari nga shoqatat profesionale të licencuar nga KKRF-ja.

Komisioni bëri këto ndryshime në nenin 13: në paragrafin 1 shtohet fjala “profesional dhe” para fjalës “i pavarur”, në paragrafin 2.2 “një anëtar nga universitetet” zëvendësohet me “dy anëtarë nga

universitetet”, paragrafi 2.4 fshihet, në paragrafin 5.2 “punë relevante” zëvendësohet me fjalinë “në fushën e kontabilitetit, financave ose auditimit” dhe në paragrafin 10 fshihet fjalia “por jo më pak se dhjetë herë në vit”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimet e propozuara në **nenin 13**.

Kryetarja, propozoi në nenin 14, paragrafi 3 të riformulohet si në vijim: “udhëheqësi dhe nëpunësit e Sekretarisë zgjidhen sipas Ligjit për Shërbimin Civil”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimin e propozuar në **nenin 14**.

Kryetarja, propozoi në nenin 17, paragrafi 1 të riformulohet si në vijim: “KKRF-ja deri më 30 qershor duhet t’i dorëzojë Qeverisë raport për”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimin e propozuar në **nenin 17**.

Kryetarja, propozoi në nenin 20, paragrafi 3 të riformulohet si në vijim “kandidatëve për kontabilistë të certifikuar do t’u kërkohet të kenë diplomë universitare në fushën e ekonomisë dhe biznesit, tri (3) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit dhe të kenë kaluar provimin e certifikimit për këtë qëllim”.

Hykmete Bajrami, propozoi në nenin 20, paragrafi 4 të riformulohet si një vijim: “sipas paragrafit 3 të këtij neni, arsimi profesional për kontabilistët e certifikuar duhet të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe direktivat relevante të Komisionit Evropian për këtë qëllim”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimet e propozuara në **nenin 20**.

Hykmete Bajrami, propozoi në nenin 22, nënparagrafi 1.1 të fshihet dhe nënparagrafi 1.2 të riformulohet si në vijim: “KKRF-ja i njeh licencat e lëshuara nga BKSFR-ja para miratimit të këtij ligji”.

Komisioni miratoi një zëri ndryshimet e propozuara në **nenin 22**.

Pas diskutimeve dhe ndryshimeve të bëra në projektligj, komisioni nxorri këtë:

P Ë R F U N D I M

Miratohen amendamentet nga grupi punues dhe i rekomandohet. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurën e mëtutjeshme në Kuvend.

5. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj